

Programi Përgatitor për Ekspertë të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Bliterm, e licencuar nga **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** dhe e akredituar nga **Autoriti Kombëtar i Kulaifikimeve të Kosovës**, ofron programin profesional përgatitor për **Ekspertë të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP)** – një trajnim i avancuar i konceptuar për kandidatët që synojnë të zhvillojnë karrierë profesionale në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Ky program është i dizajnuar për të siguruar kompetenca të standardizuara, të mbështetura në kornizën ligjore dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Qëllimi i Programit

Programi synon të:

- Pajisë pjesëmarrësit me njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi rreziqet në vendin e punës;
- Përgatisë ekspertë të aftë të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë faktorët e rrezikut;
- Ofron kompetencat e nevojshme për të ushtruar profesionin e ekspertit në SSHP brenda organizatave të ndryshme ose si ofrues të shërbimeve të jashtme të SSHP;
- Ngrisë kapacitetet profesionale të kandidatëve që synojnë të punojnë në industri me risk të ulët deri në të lartë.

Pas përfundimit të suksesshëm, kandidati është i gatshëm të kontribuojë në krijimin e një kulture të qëndrueshme të sigurisë në çdo organizatë.

Pse të zgjedhësh programin tonë?

- **Ekspertë me përvojë** shumëvjeçare në sektorin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
 - **Metoda të avancuara mësimore**, të bazuara në raste reale nga terreni
 - **Përgatitje e plotë teorike + praktike**, e harmonizuar me kërkesat aktuale të tregut
 - **Certifikatë me 8 kredi**, e vlefshme për ushtrimin e profesionit sipas standardeve në fuqi
-

Kushtet e Pranimit

Për regjistrim në program, kandidati duhet të plotësojë kriteret vijuese:

- Arsimit universitar në:
 - Shkenca teknike
 - Mjekësi
 - Juridik
 - Ose fusha të ngjashme që lidhen me aplikimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë
 - Përvojë pune:
 - Minimum 3 vite përvojë të përgjithshme, ose
 - Minimum 1 vit përvojë e drejtpërdrejtë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë
-

Modulet e Programit

Programi përbëhet nga module të strukturuar në mënyrë progresive për të ofruar një qasje të plotë dhe profesionale:

1. Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar për SSHP

Hyrje në kornizën ligjore, standardet ndërkombëtare dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira.

2. Vlerësimi i riskut në vendin e punës

Metodologjitë e vlerësimit të riskut, identifikimi i faktorëve të rrezikut dhe hartimi i dokumenteve profesionale.

3. Masat parandaluese dhe mbrojtëse

Planifikimi dhe zbatimi i masave teknike, organizative dhe mbrojtëse.

4. Informimi dhe komunikimi me të punësuarit

Qasjet moderne për informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit mbi rreziqet.

5. Trajnimi i punëtorëve

Teknikat efektive të prezantimit dhe trajnimit në kompani.

6. Monitorimi dhe mbikëqyrja

Sistemet e kontrollit, auditimet e brendshme dhe raportimi sipas standardeve profesionale.

Metodologjia e Trajnimit

Trajnimi realizohet përmes:

- Ligjëratave interaktive nga ekspertë të licencuar
- Shembujve dhe analizave nga praktika reale
- Ushtrimeve praktike dhe punës së pavarur
- Diskutimeve profesionale dhe simulimeve
- Vlerësimeve gjatë dhe në fund të trajnimit

Qasja jonë kombinon teorinë me praktikën për të garantuar kompetencë të plotë profesionale.

Kohëzgjatja dhe Organizimi

- **Orari i mësimi:**
3 herë në javë
- **Lokacioni:** Prishtinë
- **Fondi i orëve: 160 orë**

Certifikata jepet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha moduleve dhe vlerësimeve.

APLIKO TANI: _____